



Prishtinë, 30 tetor 2018
Kodi i ZRRE-së: V_1065_2018

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,

Bazuar në:

- Dispozitat e Nenit 9, paragrafi 1, nën paragrafi 1.7, Nenit 15 paragrafi 1 nënparagrafi 1.5, Nenit 25, Nenit 26 paragrafi 1, nën paragrafi 1.2, Nenit 46 paragrafi 1 nënparagrafi 1.2, Nenit 47 dhe Nenit 48 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Ligji Nr. 05/L-084);
- Dispozitat e Nenit 37 të Ligjit për Energjinë Elektrike (Ligji Nr. 05/L-085);
- Rregullën për vendosjen e të hyrave për Furnizuesin me Shërbim Universal (Rregulla për të Hyrat e FSHU);
- Vendimin e ZRRE-së për Furnizuesin e Shërbim Universal (FSHU/KESCO) nr. V_1040_2018, i aprovuar për të Hyrat e Lejuara Maksimale që do të mbulohen nga Furnizuesi i Shërbimit Universal;
- Propozimin e KESCO SH.A. - Furnizuesit për Shërbime Universal për strukturën tarifore, të dërguar 23 tetor 2018 në ZRRE, në kuadër të Shqyrtimit të Tarifave të Energjisë Elektrike,

në seancën e mbajtur më 30 tetor 2018 nxori këtë:

V E N D I M

- I. **APROVOHEN** - tarifatat me pakicë të energjisë elektrike për konsumatorët me shërbime universale të furnizimit, që do të zbatohen nga i licencuari KESCO SH.A., duke filluar nga data 1 nëntor 2018 deri në shqyrtimin e rregullt tarifor.
- II. Struktura e tarifave me pakicë e energjisë elektrike për konsumatorët me shërbime universale të furnizimit është në përputhje me Kreun VII, Metodologjia për Strukturën Tarifore të "Rregullës për të Hyrat e FSHU".
- III. Në fund të çdo viti relevant tarifor do të bëhet përshtatja vjetore e të hyrave përmes Faktorit të përshtatjes së të hyrave.
- IV. Struktura e tarifave me pakicë e energjisë elektrike për konsumatorët me shërbime universale të furnizimit, e cila do të zbatohet nga data nëntor 2018, është paraqitur në tabelën e mëposhtme të këtij Vendimi:

Tabela.1: Tarifa me pakicë e Energjisë Elektrike për konsumatorët e rregulluar tariforë

Grupi Tarifor	Niveli i tensionit të furnizimit	Elementi Tarifor	Njësia	Koha gjatë ditës	Aprovuar 2018
1	35kV	Tarifa fikse e konsumatorit	€/konsumator/muaj		11.19
		Fuqia e angazhuar	€/kW/muaj		5.85
		Energjia aktive (P), prej së cilës	€/kWh	Tarifë e Lartë	4.92
			€/kWh	Tarifë e Ulët	3.16
Energjia reaktive (Q)	€/kVARh		0.67		
2	10kV	Tarifa fikse e konsumatorit	€/konsumator/muaj		4.62
		Fuqia e angazhuar	€/kW		5.04
		Energjia aktive (P), prej së cilës	€/kWh	Tarifë e Lartë	5.73
			€/kWh	Tarifë e Ulët	3.69
Energjia reaktive (Q)	€/kVARh		0.67		
3	0.4 kV Kategoria I (konsumatorët e mëdhenj të energjisë reaktive)	Tarifa fikse e konsumatorit	€/konsumator/muaj		2.57
		Fuqia e angazhuar	€/kW		2.97
		Energjia aktive (P), prej së cilës	€/kWh	Tarifë e Lartë	6.69
			€/kWh	Tarifë e Ulët	4.96
Energjia reaktive (Q)	€/kVARh		0.67		
4	0.4kV Kategoria II	Tarifa fikse e konsumatorit	€/konsumator/muaj		2.97
		Fuqia e angazhuar	€/kW	Tarifë e vetme	8.83
		Energjia aktive (P), prej së cilës	€/kWh	Tarifë e Lartë	10.71
			€/kWh	Tarifë e Ulët	5.30
5	0.4kV matësi 2 tarifor (2-vlerësh, shtëpiak)	Tarifa fikse e konsumatorit	€/konsumator/muaj		1.74
		Energjia aktive (P), prej së cilës	€/kWh	Tarifë e Lartë	6.75
			€/kWh	Tarifë e Ulët	2.89
6	0.4kV matësi 1 tarifor (1-vlerësh, shtëpiak)	Tarifa fikse e konsumatorit	€/konsumator/muaj		1.74
		Energjia aktive (P), prej së cilës	€/kWh		5.32
7	0.4kV (shtëpiak pa matës)	Tarifa fikse e konsumatorit	€/konsumator/muaj		1.74
		Energjia aktive (P), prej së cilës	€/kWh		6.75
8	Ndriçimi Publik	Tarifa fikse e konsumatorit	€/konsumator/muaj		3.21
		Energjia aktive (P), prej së cilës	€/kWh	Tarifë e vetme	9.24

Tarifa e lartë aplikohet prej orës 07:00 - 22:00 gjatë periudhës 1 tetor 31 mars

Tarifa e ulët aplikohet prej orës 08:00 - 23:00 gjatë periudhës 1 prill deri më 30 shtator


Konsumatori ngarkohet me energji reaktive mbi atë të lejuarën që korrespondon me $\cos(\Phi) < 0.95$

ARSYETIM

- ✚ ZRRE me datë 23 tetor 2018 në kuadër të Shqyrtimit të Tarifave të Energjisë Elektrike , nga KESCO SH.A. Furnizuesit për Shërbime Universal propozimin për Strukturën e re tarifore.
- ✚ ZRRE me rastin e përcaktimit të tarifave me pakicë të energjisë elektrike për konsumatorët me shërbime universale të furnizimit, ka marrë parasysh dokumentet që janë lëshuar dhe publikuar në ueb faqen zyrtare të ZRRE-së:
 - Raport Konsultativ për të Hyrat e Lejuara Maksimale Shqyrtimi Periodik për OST/OT, i publikuar me datën 24 gusht 2018;
 - Raport Konsultativ për të Hyrat e Lejuara Maksimale Shqyrtimi Periodik për OSSH, i publikuar me datën 24 gusht 2018;
 - Raport Konsultativ për të Hyrat e Lejuara Maksimale- Furnizuesi me Shërbim Universal, i publikuar më datën 13 shtator 2018;
 - Raport Përfundimtar për të Hyrat e Lejuara Maksimale OST/OT – Përgjigjet ndaj Komenteve, i publikuar me datën 24 shtator 2018;
 - Raport Përfundimtar për të Hyrat e Lejuara Maksimale OSSH– Përgjigjet ndaj Komenteve, i publikuar me datën 24 shtator 2018;
 - Raport Përfundimtar për të Hyrat e Lejuara Maksimale për FSHU-në – Përgjigjet ndaj Komenteve, i publikuar me datën 15 tetor 2018;
 - Bordi i ZRRE pas vlerësimit dhe analizimit të raporteve relevante dhe pas shqyrtimit të komenteve të pranuar nga palët, dhe duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.
- V. Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.
- VI. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i ZRRE-së, i cili dhe do të zbatohet nga KESCO SH.A. - Furnizuesi i Shërbimit Universal, duke filluar nga data 01 nëntor 2018 deri në shqyrtimin e rregullt tarifor.

Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të inicioj konflikt administrativ në gjykatën kompetente, tridhjetë (30) ditë, nga data e pranimet të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.


Bordi i ZRRE-së:



Arsim Janova, u.d. Kryesues



Besim Sejfiqaj, Anëtar



Selman Hoti, Anëtar



Izet Rushiti, Anëtar

Vendimi iu dërgohet:

- Furnizuesit me Shërbim Universal (KESCO), dhe
- Arkivit të ZRRE-së.